

KONTRATE

Për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar

«ALB-KINE»

Ndërmjet

1. - Firma tregtare shqiptare «**DONIKA**» me qendër në **Tiranë** (Shqipëri) dhe që drejtohet nga pronari i saj **z. Irfan Hasan Hysenbelliu**

2. - Zonjës **Lin Jun**, banuese në Kinë, shtetase e huaj.

Në bazë të kësaj kontrate, palët (që më poshtë do quhen ortakë), të nisur nga interesa të dobishme dhe me vullnetin e tyre të lirë, kanë dakord për sa vijon:

1. Të krijojnë Shoqërinë e Përbashkët private shqiptaro-kineze me përgjegjësi të kufizuar, të quajtur «**ALB-KINE**», si shoqëri tregtimi artikuj të ndryshëm, investimesh dhe eksport-importi.

2. Qendra e Shoqërisë është në **Tiranë** (Shqipëri), në **Lagjen Nr.20, Rruga «Bajram Curri», Pall.438/3, Sh.3, Ap.44, Tiranë.**

3. Shoqëria bëhet person juridik dhe zbaton rigorozisht legjislacionin shqiptar në fuqi, me regjistrimin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar.

4. Shoqëria «**ALB-KINE**» do të ushtrojë veprimtarinë e vet për një periudhë prej **99 vjetësh** dhe do të pushojë në fund të vitit **2096** në qoftë se palët nuk do të bien dakord për ripërsëritjen e kësaj kontrate.

Shoqëria merr përsipër detyrimin që të realizojë aktivitetin e përcaktuar në nenin 4 të Statutit të saj.

5. Statuti i Shoqërisë, i miratuar rregullisht nga palët pjesëmarrëse, i bashkëlidhet kësaj Kontrate dhe bëhet pjesë përbërëse e saj. Të drejtat e detyrimet e ortakëve të caktuara në statut vlejné edhe për personat e tjerë që mund të bëhen pjesëtarë (ortakë) të Shoqërisë në t'ardhme

6. Kapitali fillestar i Shoqërisë është **2000 dollarë USA** ose **200000 lekë shqiptare**, të ndara në 1000 \$ USA secila dhe në lekë shqiptare 100.000 secila palë.

7. Palët pjesëmarrëse në Shoqëri (ortakët) vendosin që fillimisht të marrin pjesë me kapitale si më poshtë:

Firma «**DONIKA**» nënshkruan 50% kuota baraz me **100.000** lekë shqiptare, ose 50% (pesëdhjetë) përqind të kapitalit të Shoqërisë së Përbashkët; kurse zonja Lin Jun 50% (pesëdhjetë) baraz me **100.000** lekë shqiptare, ose 50% (pesëdhjetë) përqind të kapitalit të Shoqërisë së Përbashkët.

8. Në zbatim të nenit 6 të Statutit të Shoqërisë, derdhja e kapitalit në kuotat e mësipërme do të bëhet ekskluzivisht në likuid (para) në një llogari të veçantë që do të hapet në Bankën Shqiptare me emrin e Shoqërisë së formuar dhe në mënyrën që vijon:

Firma «**DONIKA**» do të derdhë **100.000** lekë shqiptare brenda dy muajve ose **1000 \$ USA**; kurse zonja Lin Jun do të derdhë **100.000** lekë shqiptare gjithashtu po brenda dy muajve, ose **1000 \$ USA**.

9. Shoqëria e Përbashkët «**ALB-KINE**» për tre vjetët e parë do të drejtohet nga një Këshill Administrativ i përbërë nga vetë ortakët:

a) z. Irfan Hysenbelliu, i biri i Hasanit dhe i Fiqiretes, lindur në Potom të Skraparit më 08.04.1959 e banues në Lagjen Nr.20, Rruga «Bajram Curri», Pall. 438/3, Hyrja 3, në Tiranë.

b) Zonja Lin Jun, e bija e Li Yongfa dhe Han Xhin Ying, lundur në Shang Dong China, më 01.01.1969, banon në Pekin në Distriktin, Hajidian, Rruga «Wan Shan Rood».

Të lartpërmendurve u atribuohen këto detyra:

Z. Irfan Hysenbelliu emërohet **President** i Shoqërisë, kurse

Z. Lin Jun emërohet **Zëvendëspresidente** e Shoqërisë.

10. Ortakët deklarojnë dhe impenjohen:

- Të sjellin e të furnizojnë Shoqërinë me gjithë teknikën dhe teknologjinë e nevojshme për drejtimin, projektimin, ndërtimin, riaktivizimin, modernizimin dhe zgjerimin e linjave të prodhimit, të sektorëve e fabrikave ekzistuese, si dhe atyre të rinj, që do të shfrytëzohen nga Shoqëria;

- Të sigurojnë importe e eksporte artikujsh nga më të ndryshmit, si pjesë këmbimi automjetesh e makinerish, si dhe artikuj të tjerë që paraqesin kërkesa në treg, duke respektuar legjislacionin në fuqi:

- Të sigurojnë e të punësojnë fuqi punëtore midis shtetasve shqiptarë që banojnë në Shqipëri, në kontigjentet dhe nevojat që

[Signature]

[Signature]

burojnë nga aktiviteti në rritje i Shoqërisë;

- Të konfirmojnë dhe respektojnë detyrimet që burojnë nga legjislacioni i punës, nga kontratat vetiake apo kolektive me punonjësit, me organizmat e tyre, duke plotësuar e përmirësuar në vazhdimësi nevojat dhe kushtet ekonomiko-shoqërore të punonjësve.

11. Shoqëria «**ALB-KINE**» përballon humbjet vetëm deri në vlerën e kapitalit bazë të saj. Themeluesit e Shoqërisë (ortakët) nuk përgjigjen për detyrimet që rrjedhin nga veprimtaria e shoqërisë tej kapitalit bazë të saj.

12. Për problemet dhe aspektet që nuk janë parashikuar shprehimisht në këtë Kontratë, palët pjesëmarrëse të Shoqërisë (ortakët) detyrohen t'i referohen legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe sidomos në Shqipëri.

13. Kjo Kontratë, pas dhënies së autorizimeve e miratomeve nga organet kompetente shqiptare, hyn në fuqi menjëherë.

14. Zoti **Irfan Hysenbelliu** dhe zonja **Lin Jun** janë të detyruar që, sëbashku të hartojnë e t'i bashkëlidhin kësaj Kontrate Stratutin e Shoqërisë «**ALB-KINE**» dhe gjithë dokumentet e tjera të nevojshme që mund të kërkohen nga organet kompetente për regjistrimin e Shoqërisë.

Tiranë, më 10.7.1993

K O N T R A K T U E S I T

Presidenti i Firmës
«**DONIKA**»

(Zoti **IRFAN HYSENBELLIU**)

Presidenti i Firmës
«**DAPHINE**»

(Zonja **Lin Jun**)

Irfan Hysenbelliu
L. Sh. Hysenbelliu

Lin Jun

Irfan

J

STATUTI

Neni 1

Emri dhe forma e shoqërisë

Shoqëria e formuar sipas kontratës ndërmjet firmës shqiptare «**DONIKA**» dhe firmës kineze «**DAPHINE**» emërtohet «**ALB-KINE**». Shoqëria është me përgjegjësi të kufizuar.

Neni 2

Vendndodhja e shoqërisë

Qendra e shoqërisë është në Tiranë (Shqipëri), Lagja Nr. 20, Rruga «Bajram Curri», Pallati Nr. 438/3, Shkalla 3, Ap. 44.

Në të ardhmen mund të krijohen vendqendrimet të tjera në territorin e Republikës së Shqipërisë ose në ndonjë shtet tjetër.

Neni 3

Kohëzgjatja e shoqërisë.

Shoqëria do të veprojë për një periudhë kohe prej 99 vjetësh; domethënë ajo do të pushojë së ekzistuari më 31 dhjetor 2096. Por, me vendim të Presidentit periudha e veprimtarisë së Shoqërisë mund të shkurtohet ose të zgjatet tej këtij afati.

Neni 4

Objekti i Shoqërisë

Shoqëria «**ALBA-KINE**» me mjetet e veta financiare ushtron aktivitet privat në fushat e veprimtarisë së prodhimit industrial, artizanal, bujqësor, të ndërtimit, të tregtisë së brendshme e të jashtme, të komunales, të transportit dhe të fushave të tjera të mundshme, duke siguruar bazën materialo-teknike në sektorët shtetërorë, si dhe me personat juridikë ose fizikë vendas apo të huaj, sipas legjislacionit në fuqi për eksport-importin.

Shoqëria zhvillon tregtimin e artikujve industrialë, elektroshtëpiakë, ushqimorë, bujqësorë e blegtoralë, të pijeve alkoolike e joalkoolike, të artikujve të veshmbathjes, atyre kimikë e kozmetikë, si dhe të pjesëve të këmbimit për automjete e makineri të ndryshme (të gjitha këto me shumicë ose pakicë).

[Signature]

[Signature]

[Signature]

Shoqëria merr përsipër të bëjë investime në fushën e mjekësisë, të turizmit e transportit, në përmirësimin e teknologjisë së përpunimit, pasurimit e eksportimit të mineraleve, të konservimit të artikujve e prodhimeve të ndryshme si dhe të ambalazhimit, duke synuar realizimin e veprimtarisë tregtare fitimprurëse në këto drejtime.

Gjithashtu Shoqëria, duke bashkëpunuar e kooperuar me firma ose persona juridikë vendës e të huaj dhe duke synuar nxjerrjen e fitimeve, merr përsipër ndërtimin e sektorëve, punishteve dhe fabrikave të reja në Shqipëri, si dhe përmirësimin apo ristrukturimin e atyre ekzistuese në fushat ku paraqitet interes shtetëror apo shoqëror.

Neni 5

Palët pjesëmarrëse në Shoqëri (ortakët) vendosin që fillimisht të marrin pjesë me kapitale si më poshtë:

Firma «**DONIKA**» nënshkruan 50% kuota baraz me **100.000** lekë shqiptare, ose 50% (pesëdhjetë) përqind të kapitalit të Shoqërisë së Përbashkët; kurse zonja Lin Jun 50% (pesëdhjetë) baraz me **100.000** lekë shqiptare, ose 50% (pesëdhjetë) përqind të kapitalit të Shoqërisë së Përbashkët.

Në zbatim të nenit 6 të Statutit të Shoqërisë, derdhja e kapitalit në kuotat e mësipërme do të bëhet eskuzivisht në likuid (para) në një llogari të veçantë që do të hapet në Bankën Shqiptare me emrin e Shoqërisë së formuar dhe në mënyrën që vijon:

Firma «**DONIKA**» do të derdhë **100.000** lekë shqiptare brenda dy muajve ose **1000** \$ USA; kurse zonja Lin Jun do të derdhë **100.000** lekë shqiptare gjithashtu po brenda dy muajve, ose **1000** \$ USA.

Neni 6

Shoqëria e Përbashkët «ALB-KINE» për tre vjetët e parë do të drejtohet nga një Këshill Administrativ i përbërë nga vetë ortakët:

a) Z. Irfan Hysenbelliu, i biri i Hasanit dhe i Fiqiretes, lindur në Potom të Skraparit më 08.04.1959 e banues në Lagjen Nr.20, Rruga «Bajram Curri», Pall. 438/3, Hyrja 3, në Tiranë.

b) Zonja Lin Jun e bija e Li Yongfa dhe i Han Xhin Ying, lindur në Shang Dong CHina, 01.01.1969, banon në Pekin në Distring Hordion, rruga «Wan Shan Rood»

Të lartpërmendurve u atribuohen këto detyra:

Z. Irfan Hysenbelliu emërohet **President** i Shoqërisë, kurse **Z. Lin Jun** emërohet **Zëvendëspresidente** e Shoqërisë.

Neni 7

Rritja e kapitalit dhe shtimi i pjesëtarëve (ortakëve) të shoqërisë

Kapitali i shoqërisë mund të rritet çdo vit në masën që përcaktohet vetë ortakët.

Gjithashtu, mund të shtohet numri i pjesëtarëve të shoqërisë (ortakëve) me pëlqimin e ortakëve themelues të Shoqërisë të cilët përcaktojnë edhe sasinë e pjesëve në para që duhet të arkëtojnë.

Neni 8

Shoqëria është pronare e pasurisë së saj dhe ka të drejtën e përdorimit dhe të disponimit të kësaj pasurie në përputhje me qëllimin dhe objektin e veprimtarisë që kryen.

Shoqëria gëzon të drejtat për mbrojtjen e pasurive të saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe ligjin për mbrojtjen e investimeve të huaja.

Neni 9

Shoqëria krijon fondin rezervë dhe fondet e tjera financiare, për zhvillimin e saj.

Përbërja, shuma e përgjithshme, burimet për krijimin e fondit rezervë, përdorimin e rregullimin e tij caktohen nga këshilli administrativ në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Shoqëria i disponon plotësisht mjetet e saj financiare.

Neni 10

E ardhura bruto e Shoqërisë, pasi zbriten shpenzimet përbën fitimin e realizuar, i cili ndahet ndërmjet ortakëve në përpjestim me pjesën (kuotat) e vënë në kapitalin themelor të Shoqërisë.

Fitimi që i takon ortakut të huaj, në përputhje me legjislacionin shqiptar, mund të transferohet jashtë shtetit pa asnjë pengesë.

Neni 11

Pasuritë e Shoqërisë vlerësohen në bilancet e saj në përputhje me dispozitat ligjore të zbatueshme në Shqipëri.

Neni 12

Veprimtaria financiare e Shoqërisë realizohet në bazë të planeve financiare që bëjnë pjesë në planin e veprimtarisë ekonomiko-tregtare. Planet financiare parashikojnë aktivin dhe pasivin e veprimtarisë së Shoqërisë.

Neni 13

Të drejtat dhe detyrat e ortakëve

Ortakët gëzojnë këto të drejta kryesore:

a. Administrimin e veprimtarisë së Shoqërisë në përputhje me kontratën e statutin.

b. Pjesëmarrjen në rezultatet e çdo forme e sasi të veprimtarisë së shoqërisë të parashikuar në kontratë e statut.

c. Pjesëmarrjen vetë ose me anën e përfaqësuesve të vet në të gjitha organet e Shoqërisë.

ç. Nxjerrjen e të gjitha të dhënave që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike e tregtare dhe me veprimtarinë tjetër të shoqërisë, si dhe njohjen me të gjitha dokumentet e përpunuara nga Shoqëria si bilancet dhe llogaritë ekonomike.

d. Rritjen ose pakësimin e kapitalit bazë të shoqërisë.

dh. Pranimin e ortakëve të rinj, si dhe përjashtimin e tyre për shkelje të rënda të këtij Statuti;

e. Heqjen dorë nga Shoqëria duke ja ofruar pjesën (kuotën) e vet sipas zgjedhjes ortakëve të tjerë dhe vetëm kur nuk bëhet një zgjedhje e tillë nga ortakët, kuota mund t'u evokohet të tretëve. Çdo veprim i mësipërm duhet të pasqyrohet i dokumentuar në regjistrin përkatës të kompanisë në dy gjuhë: shqip dhe anglisht.

Neni 14

Ortakët kanë këto detyrime kryesore:

a. Të depozitojnë pjesën (kuotën) e tyre, në përputhje me kontratën e statutin.

b. T'i japin Shoqërisë të dhënat e nevojshme.

c. Të kryejnë detyrat për realizimin e objektivave e të funksioneve të Shoqërisë.

d. Çdo fund muaji duhet të bëhet bilanci ekonomik dhe të dokumentohet. Të parashikohet e dokumentuar gjendja e tregut që ka nevojë për tre muaj.

Neni 15

Secili ortak ka të drejtë të heqë dalë nga Shoqëria, duke i njoftuar vendimin e tij asambles" së ortakëve 1 vit përpara dhe duke _____ të drejtën e zgjedhjes sipas nenit 13 shkronja « e » të këtij statuti.

- Heqja dorë nuk e liron ortakun nga detyrimet e marra më parë ndaj Shoqërisë dhe nuk pezullon detyrimet e Shoqërisë ndaj ortakut.

- Ortaku dorëheqës duhet t'ja ofrojë për shitje pjesën (kuotat) një ortaku tjetër dhe kur ky i fundit nuk e pranon këtë blerje, ortaku dorëheqës brenda 30 ditëve nga data e njoftimit, mund t'ua shesë kuotat e tij të tretëve, por jo me çmim më të ulët nga ai i ofruar ortakut.

[Signature]

[Signature]

[Signature]

Neni 16

Asamblea e ortakëve

Organi vendimor i Shoqërisë është asamblea e ortakëve. Në të marrin pjesë ortakët me të drejtë vote sipas madhësisë së pjesëmarrjes në kapitalin themelor.

Asamblea e ortakëve vendos për bilancin vjetor, për ndryshimet në statut, për shtimin ose pakësimin e kapitalit themelor të shoqërisë, për ecurimin e anëtarëve të këshillit administrativ, për ecurimin e komisionit të revizionit kontabël, për miratimin e programit vjetor të veprimtarisë së Shoqërisë, për zgjatjen e afatit të veprimtarisë së Shoqërisë si dhe për mbrojtjen e veprimtarisë së Shoqërisë.

Unanimiteti në vendimet e asamblesë së ortakëve është i nevojshëm për këto çështje:

- Ndryshimet në statut
- Rritjen ose pakësimin e kapitalit themelor.

Për çështje të tjera asamblea e ortakëve vendos me shumicë votash. Në asamblenë e ortakëve çdo aksion përfaqësohet nga një votë.

- Çdo ndryshim i llogarisë bankare të pasqyrohet në dokumentacion.

Neni 17

Shoqëria për tre vjetët e parë do të drejtohet nga një këshill administrativ i përbërë nga vetë ortakët:

Në kompetencën e këshillit administrativ janë:


- a) Përcaktimi i strukturës të aparatit të Shoqërisë
- b) Krijimi i organeve të tjera të domosdoshme për realizimin e objektivave të Shoqërisë.

c) Marrja e vendimeve për kërkimin e kredive afatgjata kryetari i Këshillit administrativ që do të jetë dhe President i Shoqërisë ku për detyrë të sigurojë drejtimin e Shoqërisë si dhe:

- Të përfaqësojë Shoqërinë në lidhje me të tretët, brenda kufijve të veprimtarisë së saj, përveç çështjeve që kërkohen unanimitetin e ortakëve, ose që kanë të bëjnë me kompetencat që ky statut ja jep asamblesë së ortakëve.

- Të organizojë punën e këshillit administrativ e ta mbledhë atë në afate të caktuara ose sa herë që do të jetë e nevojshme.

- Të sigurojë zbatimin e saktë të vendimeve të asamblesë së ortakëve dhe të këshillit administrativ.



Unanimiteti në vendimet e këshillit administrativ është i domosdoshëm, për këto çështje:

- Hapjen e letërkredive në kohë e në valutë të huaj.
 - Përcaktimin e numrit të punonjësve e të pagave të tyre.
- Për çështje të tjera këshilli administrativ vendos me shumicë votash.

Neni 18

Presidenti dhe zv. presidenti në tre vjetët e para do të kryejnë edhe veprimtarinë operative të Shoqërisë, pra do të jenë edhe organ ekzekutiv i saj, do të organizojnë punën për realizimin e planeve ekonomike të shoqërisë, do përfaqësojnë ndërmarrjen përpara të tretëve në gjykatë dhe arbitrazh dhe do të nënshkruajnë kontrata në emër e përllogari të shoqërisë.

Zv. Presidenti përfaqëson Shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët në mungesë të Presidentit ose me urdhër të tij.

Neni 19

Mbyllja e Shoqërisë

Veprimtarie e Shoqërisë pushon në datën _____, Me vendim të asamblesë së ortakëve mund të bëhet shpërndarja e shoqërisë para datës së caktuar më sipër dhe në këtë rast Këshilli Administrativ përcakton modalitetet, kohën dhe mënyrat e likuidimit të ortakëve, të punonjësve të shoqërisë dhe të kreditorëve të tjerë.

Neni 20

Mosmarrëveshjet midis ortakëve

Në rast se gjatë veprimtarisë së shoqërisë lindin mosmarrëveshje midis ortakëve, këto duhet të zgjidhen në mirëkuptim midis tyre dhe, në rast të kundërt, nga arbitrazhi shtetëror ose Gjykata e Tiranës.

[Signature]
10/03

[Signature]

[Signature]

DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 22

Për çështjet ose problemet që nuk kanë gjetur pasqyrim shprehimisht në këtë Statut ortakët janë të detyruar t'u referohen dispozitave ligjore shqiptare që i parashikojnë ato.

Neni 23

Statuti i Shoqërisë përpilohet në gjuhën shqip dhe Anglisht, duke patur të dy tekstet ndër të barabartë.

Tiranë, më 10. 8. 1993.

KONTRAKTUESIT

Presidenti i Firmës
«**DONIKA**»

(Zoti **IRFAN HYSENBELLIU**)



Presidenti i Firmës
«**DAPHINE**»

(Zonja **Lin Jun**)



Përkthyes
L. Shkurto
